



REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimar / Dorezuar Priljeqen/Prodato Received/Delivered	30.12.2022	2	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org./Unit	Nr. Prof Bil. Prof Prof No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SKAMSHICK	8699/2022		113



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1204/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj-Demi-anëtarë, me Ilire Mehmeti Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1204/2022 të datës 16.12.2022 të parashtruar nga ankuesi [redacted] me adresë [redacted] kundër organit të punësimit/Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike "*Kompensim material*", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 30.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1204/2022 e datës 16.12.2022 e parashtruar nga ankuesi [redacted]

A r s y e t i m

Ankuesi [redacted] i punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datë 16.12.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokollit 8155/2022 të regjistruar nën shenjen A.nr.1204/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër përgjigjes me shkrim të datës 15.12.2022 të organit të punësimit me të cilin i është refuzuar kërkesa për kompensimin e mjeteve financiare në mënyrë retroaktive në emër të diferencës së një koeficienti të pagës nga dita e nënshkrimit të Aktit të Emërimit me datë 08.07.2014.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje në mënyrë meritore administroi këto prova: Ankesën me numër të protokollit 8155/2022 të datës 16.12.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Emalin e datës 09.12.2022 nga ankuesi; Kërkesën e datës 15.12.2022 nga ankuesi për harmonizim të koeficientit të pesës retroaktive; Përgjigjen e datës 15.12.2022 për ankuesin; Kërkesën për ngritjen e koeficientit e datës 02.09.2022 nga ankuesi; Akt Emërimit Nr.03/SHC/2022 i datës 09.12.2022; Vendimin



A.nr.860/2022 i datës 25.11.2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Shkresën e datës 20.11.2014 nga Ministria e Administratës Publike; Akt Emërimin e ankuesit i datës 08.07.2014; Certifikatën e datës 14.01.2010.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, nga shqyrtimi i shkresave të bashkangjitura të lëndës të dërguara nga ankuesi dhe organi përkatës i punësimit, ka konstatuar se ankesa A.nr.1204/2022 e datës 16.12.2022 e parashtruar nga ankuesit *është e pabazuar, sepse:*

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në pozitën e punës Zyrtar për Pranimin e Mallrave.

Kolegji i Këshillit nga provat e administruara të lëndës ka gjetur se ankuesi më datë 04.10.2022 kishte parashtruar ankesë për harmonizimin e koeficientit të pagës nga gjashtë (6) në shtatë (7), në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Këshilli më datë 25.11.2022 me Vendim A.nr.860/2022 ka aprovuar ankesën e ankuesit si të bazuar dhe ka obliguar organin përkatës të punësimit që ankuesit t'ia harmonizoj koeficientin e pagës me titullin e pozitës dhe përshkrimin e vendit të punës, nga gjashtë (6) në shtatë (7), ku si rrjedhojë organi përkatës i punësimit, respektivisht Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datë 09.12.2022 ankuesit i ka lëshuar Akt Emërimin Nr.02/SHC/2022 me koeficient të pagës shtatë (7).

Rrjedhimisht, ankuesi më datë 15.12.2022 i është drejtuar me kërkesë me numër protokollit 8457 organit të punësimit për kompensimin e diferencës së koeficientit të pagës në mënyrë retroaktive nga dita e nënshkrimit të Aktit të Emërimit me datë 08.07.2014. Njësia për Burime Njerëzore në Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, më datë 15.12.2022 ka refuzuar kërkesën e ankuesit me arsyetimin se kërkesa për pagese retroaktive nuk ka mbështetje ligjore.

I pakënaqur me përgjigjen e datës 15.12.2022 të organit të punësimit, ankuesi më datë 16.12.2022 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e diferencës së një koeficienti të pagës në mënyrë retroaktive nga dita e nënshkrimit të aktit të emërimit me datë 08.07.2014.

Kolegji i Këshillit, shqyrtoj pretendimin ankimor të ankuesit lidhur me kompensimin e diferencës së një koeficienti të pagës në mënyrë retroaktive nga dita e nënshkrimit të aktit të emërimit, me datë 08.07.2014, dhe si rrjedhojë konstatoi se pretendimi ankimor i ankuesit si i tillë nuk është i bazuar, ngase sipas shkresave të administruara të lëndës rrjedh se ankuesi me datë 08.07.2014 kishte nënshkruar aktin e emërimit për pozitën e punës Zyrtar për Pranimin e Mallrave, me koeficient të pagës gjashtë (6), dhe se i njëjti edhe përkundër faktit se ka qenë në dijeni lidhur me koeficientin e përcaktuar të pagës nuk ka ndërmarr asnjë veprim juridik deri me datë 20.10.2022, duke vepruar kështu në kundërshtim me dispozitat e Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative (ligj ky i aplikueshëm në kohen kur ankuesi kishte nënshkruar aktin e emërimit me datë 08.07.2014), përkatësisht nenin 130 të këtij ligji ku përcaktohej se: 130.1. Ankimi administrativ bëhet brenda 30 ditësh nga dita kur: a) ankuesi ka marrë njoftim për aktin ose për refuzimin për të nxjerrë aktin.



Kolegji i Këshillit me datë 25.11.2022 me Vendim A.nr.860/2022 ka aprovuar ankesën e ankuesit të datës 20.10.2022 si të bazuar dhe ka obliguar organin përkatës të punësimit që ankuesit t'ia harmonizoj koeficientin e pagës me titullin e pozitës dhe përshkrimin e vendit të punës, nga gjashtë (6) në shtatë (7), në kuptim të eliminimit të situatës se diskriminimit brenda organit përkatës të punësimit, lidhur me realizimin e të drejtës në pagë, ngase është konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit lidhur me diskriminim në pagë ishin të bazuara, mirëpo me Vendim A.nr.860/2022 të datës 25.11.2022 nuk është aprovuar pretendimi ankimor për realizimin e diferencës së pagës në mënyrë retroaktive, nga data e themelimit të marrëdhënies së punës, ngase ankuesi nuk kishte ndërmarr veprime brenda afatit ligjor të përcaktuar me dispozitat e nenit 130.1 të Ligjit Nr.02/L-28 për Procedurën Administrative.

Andaj, për sa me sipër dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda A.nr.1204/2022

Ilire Mehmeti-Shaqiri

Procesmbajtëse



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MMPHI; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së